



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 7/30 i Regjistrimit Themeltar  
Nr. 7/30 i Vendimit**

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me trup gjykues të përbërë nga :

**Sokol SADUSHI      -Kryesues  
Asim VOKSHI        -Anëtar  
Medi BICI            -Anëtar**

sot më datë 18.07.2022 mori në shqyrtim kërkesën administrative nr. 30, datë regj. 03.06.2021, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Edmonda Bejleri  
Vjollca Pupa

**PALË E INTERESUAR:** Ministria e Drejtësisë

**OBJEKTI:** Kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përshpejtimi i procedurave të gjykimit të çështjes me nr. 31025-02122-86-2017, datë 28.04.2017 që është duke u gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë  
Marrja e informacionit të nevojshëm për këtë çështje nga ana juaj kësaj gjykate, në bazë të nenit 399/4, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile.

**BAZA LIGJORE:** Neni 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, neni 48 i ligjit nr. 49/2012.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. Sokol Sadushi dhe diskutoi në dhomë këshillimit çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I. Rrethanat e çështjes.**

1. Kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga pala kërkuuese është paraqitur në Gjykatën e Lartë me datë 02.06.2021. Nëpërmjet shkresës nr. 4334 prot., datë 02.12.2021 të Kancelarit të Gjykatës së Lartë është kërkuar informacion në Gjykatën Administrative të Apelit lidhur me ecurinë e gjykimit dhe qëndrimin e gjyqtarit relator lidhur

me të. Me anë të shkresës nr. 4334/1 prot., datë 13.12.2021 gjyqtari relator ka parashtruar qëndrimin se janë në shqyrtim çështjet e e regjistruara në shtator të vitit 2016 dhe se çështja është regjistruar në datë 02.05.2017. Gjithashtu në vëmendje silltet se gjyqtari rezulton relator në mbi 3700 dosje, se planifikohen mesatarisht 30 çështje prej tij në muaj dhe se arsyet e vonesës në gjykimin e kësaj çështje janë të lidhura me pamundësinë objektive të përballimit të kësaj ngarkese brenda një afati të arsyeshëm. Konstatohet se në datë 12.01.2022 janë përcjellë aktet e fashikullit të gjykimit.

2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se kërkuesit kanë paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në datë 20.07.2016, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së shpronësimit të pasurisë së paluajtshme me pronar paditëset, sipas objektit të padisë, për shkak të mospërdorimit të saj për qëllimin për të cilin është kryer shpronësimi dhe detyrimin e palëve të paditura, Bashkia Tiranë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Këshilli Ministrave të kthejnë pasurinë palës paditëse.

3. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 405 (80-2017-410), datë 09.02.2017 ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

4. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim Avokatura e Shtetit, Bashkia Tiranë dhe Ministria e Punëve të Brendshme. Pas verifikimeve të kryera përmes sekretarisë gjyqësore rezulton se çështja ende nuk është gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

5. Pala kërkuese ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm me datë 02.06.2021. Në kërkesë është pretenduar se:

- *Nga momenti i regjistrimit të kësaj çështje, përvec periudhës së pezullimit të përcaktuar në aktin normativ për shkak të COVID 19 nuk ka pasur arsye tjetër objektive shkak për të pezulluar gjykimin e kësaj çështje.*

-*Kërkesa përmbush kriteret formale të parashikuara në nenin 399/6 të Kodit të Procedurës Civile.*

-*Çështja është regjistruar në datën 28.04.2017 dhe sipas nenit 48 të ligjit nr. 49/2012 kjo çështje duhej të ishte gjykuar brenda datës 28.05.2017, ndërsa sipas standardit të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile duhet të ishte gjykuar brenda datës 28.04.2018.*

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ**

6. Kërkesa është paraqitur pranë Gjykatës së Lartë në datë 02.06.2021. Kërkesa është paraqitur nga një subjekt i cili legjitimohet në paraqitjen e kësaj kërkesë. Kërkuesi rezulton të jetë me cilësinë e paditësit në procesin gjyqësor për të cilin është regjistruar ankimi me nr. Regj. Themeltar 31025-02122-86-2017, datë 28.04.2017.

7. Kërkesa është në kompetencën e këtij kolegji, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja b), të Kodit të Procedurës Civile, pasi përmes saj kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

8. Kërkesa i plotëson elementët e parashikuar në nenin 399/5, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu kërkesa është e shoqëruar edhe me të gjitha aktet e tjera të nevojshme, të përcaktuar në nenin 399/5, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile.

9. Rezultoni se çështja ka kaluar afatin e shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja a), të Kodit të Procedurës Civile (1 vit). Që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit (më datë 28.04.2017) dhe deri në paraqitjen e kësaj kërkesë (më datë 02.06.2021) ka kaluar një kohë prej 4 (katër) vitesh, e 1 (një) muaj dhe 5 (pesë) ditë. Nisur nga afatet e mësipërme rezultoni qartazi se është tejkaluar afati i parashikuar në nenin 399/2 shkronja a) të Kodit të Procedurës Civile.

10. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin civil/administrativ, pasi përbën dhe një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ky

parim bazohet në postulatën “drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”. Shkalla e respektimit të këtij parimi përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. (*Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ*). Periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë deri tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. (*shih vendimin Vendimin Qufaj kundër Shqipërisë; Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë 23.11.1993 të GJEDNJ*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

11. Në vlerësim të Kolegjit, parashikimet e neneve 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile kanë për qëllim krijimin e një mjeti procedural që t’u japë zgjidhje rasteve kur konstatohet neglizhencë apo tejzgjatje të procedurave, për të cilat nuk ka një justifikim të arsyeshëm me qëllim respektimin e parimit të një procesi të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNJ. Qëllimi i këtij mjeti është që t’u japë mundësi subjekteve, që ndodhen në kushtet e mësipërme, që të kenë një mjet procedural efektiv që të zgjidhin situatën në të cilën ata ndodhen dhe përmbylljen e procedurave në një kohë sa më të arsyeshme. Në këtë kuptim, ligji ka parashikuar afatet, të cilat konsiderohen të arsyeshme, sipas shkallëve të gjykimit. Neni 399/2 i KPC përcakton se afatet e arsyeshme të gjykimit duhen vlerësuar në raport me rrethanat konkrete që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, konkretisht “Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.”. Në nenin 399/9 të KPC identifikohen disa kritere në lidhje me vlerësimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, konkretisht, “[...] gjykata vlerëson kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e palëve dhe të trupit gjykues gjatë gjykimit, [...] si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen”.

12. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Në referim të kësaj jurisprudence rezulton se në përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të 4 ndryshëm, të tilla si: kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative. (*Shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjeliç kundër Sllovenisë ap. nr.50719\06, datë 18.10.2012. të GJEDNJ*).

13. Për sa i përket kompleksitetit të çështjes, ky kriter vlerësimi merr parasysh të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe i dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhja e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedure. (*Shih vendimin Trggiani kundër Italisë datë 19.02.1991; Manieri kundër Italisë dt. 27.02.1992, Stefancic kundër Sllovenisë, datë 25.10.2012 të GJEDNJ*).

14. Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, ky kriter lidhet me mënyrën se si janë sjellë palët në proces ndaj procedimit. Diligjencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij. (*shih vendimin Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane, datë 15.07.1982 të GJEDNJ*).

15. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve për vlerësimin e kohëzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen ose nga autoritetet gjyqësore ose nga autoritetet administrative. Shkaqe të kësaj natyre në jurisprudencën e GJEDNJ janë vënë në

dukje p.sh.: bashkimi i gabuar i disa çështjeve që ka shkaktuar vonesa të panevojshme, shtyrjet e pabazuara në ligj të seancave gjyqësore, pezullimi i kundërligjshëm i procesit gjyqësor, vonesat nga ana e agjencive publike ligjzbatuese të shtetit në dorëzimin e provave të kërkuara nga gjykata, transferimi i çështjeve penale nga një gjykatë në tjetrën, mbajtja e seancave të apelimeve. (*Shih vendimin Ewing kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

16. Në çështjen objekt gjykimi konstatohet se në momentin e regjistrimit të kërkesës në Gjykatën e Lartë rezulton se çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja a), të Kodit të Procedurës Civile (1 vit). Kolegji duke marrë në vlerësim kriteret e përcaktuar nga jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me standardin e afatit të arsyeshëm nuk konstaton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar, të jetë shtyrë gjykimi për shkak të kërkesave të palës kërkuese. Nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë, që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në këto momente nuk është kryer ndonjë veprim procedural. Çështja nuk paraqitet veçanërisht komplekse për nga natyra e saj.

17. Në lidhje me mosveprimin e gjykatës që nga momenti i depozitimit të ankimit e deri në datën që kërkuesi ka paraqitur kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të shqyrtimit, Kolegji vlerëson se duhet mbajtur në konsideratë neni 399/2 paragrafi 3 i KPC. Nisur nga qëllimi i këtij mjeti procedural (shmangia e neglizhencës apo e tejzgjatjes së procedurave, për të cilat nuk ka një justifikim të arsyeshëm), në vlerësim të Kolegjit, rrethanë që shkakton pamundësi objektive për procedim sipas nenit 399/2 paragrafi 3, përbën edhe një volum i madh i çështjeve, të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë në raport me një pamjaftueshmëri burimesh njerëzore për të përballuar këtë volum, sepse një situatë e tillë e vë organin gjyqësor në kushtet pamundësisë objektive për procedim. Një situatë e tillë del përtej rastit individual dhe ka të bëjë me një problematikë që përfshin sistemin në tërësi. Kolegji vlerëson se nuk mund t'i kërkohej autoriteteve gjyqësore, që të kryejnë veprime procedurale në tejkalim të limiteve të arsyeshme të mundësive të tyre objektive. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator si dhe ngarkesa e këtij të fundit në raport me gjyqtarët e tjerë. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, gjyqtarja ka depozituar mendim me shkrim ku është parashtruar se rezulton relatore në mbi 3700 dosje, se planifikohen mesatarisht 30 çështje në muaj sipas rendit kronologjik të datës së regjistrimit dhe se arsyet e vonesës në gjykimin e kësaj çështje janë të lidhura me pamundësinë objektive të përballimit të kësaj ngarkese brenda një afati të arsyeshëm.

18. Kolegji vlerëson se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Gjyqtarja relatore ka përcaktuar kriteret se si merr në shqyrtim çështjet për të cilat ajo është në cilësinë e relatores. Rezultoni se shqyrtimi i tyre bëhet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar. Kolegji, duke marrë në konsideratë rastet që GJEDNJ ka përcaktuar se çfarë përbën sjellje të gjykatës, e cila ndikon në cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, vlerëson se rastet kur gjykata është në pamundësi objektive dhe pa vullnetin e saj, për të gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë (jo për shkak të gjyqtarit), nuk do të kemi cenim të këtij standardi. Kolegji vlerëson se në rastet kur gjykata është në kushtet e pamundësisë objektive për shkak të ngarkesës së madhe, nuk mund t'i kërkojë gjykatës që të marrë masa për përsheptim të procedurave, kur konstaton se gjykata ndjek kriteret transparente dhe objektive në përcaktimin e radhës së gjykimit të çështjeve. Një interpretim i kundërt, i cili nuk do të merrte në konsideratë volumin shumë të madh të çështjeve dhe do të detyronte gjykatën të përsheptonte procedurat pa u mbështetur në kriteret objektive, do të shkaktonte pabarazi në radhën e trajtimit të çështjeve të cilat janë në rrethana të njëjta. Në rastin konkret, Kolegjit i rezulton se gjyqtarja relatore ka marrë të gjitha masat e nevojshme organizative duke

përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë ngarkuar në cilësinë e gjyqtarit relator.

19. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Duke qënë elementë të një procesi të rregullt, në çdo rast duhet të vendoset një ekuilibër i drejtë mes cilësisë së procesit dhe të vendimmarrjes së gjykatës me afatin e arsyeshëm apo edhe ekonominë gjyqësore në tërësi duke mos dëmtuar cilësinë.

20. Për sa më sipër, Kolegji çmon se duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës pasi nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e procesit nga gjyqtari relator.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 1, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar dhe nenin 399/8, pika 1 shkronja b) e Kodit të Procedurës Civile

### **VENDOSI:**

- Rrëzimin e kërkesës së kërkueseve Edmonda Bejleri dhe Vjollca Pupa.

**Tiranë, më 18.07.2022**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 8/31 i Regjistrimit Themeltar  
Nr. 8/31 i Vendimit**

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me trup gjykues të përbërë nga :

**Sokol SADUSHI     -Kryesues  
Asim VOKSHI        -Anëtar  
Medi BICI            -Anëtar**

sot më datë 18.07.2022 mori në shqyrtim kërkesën administrative nr. 31, datë regj. 24.06.2021, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Restore Reduce Recycle Albania shpk

**PALË E INTERESUAR:** Inspektoria Shtetërorë i Mjedisit Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit.  
Inspektoria Shtetërorë i Mjedisit Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, Dega Rajonale Tiranë.  
Shoqëria “Bailiff Service E.Hoxha” sh.p.k.

**OBJEKTI:** Kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjyqimit dhe përshpejtimi i procedurave të gjyqimit të çështjes me nr. 31157-02091-2019, datë 27.05.2019 që është duke u gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

**BAZA LIGJORE:** Neni 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, neni 48 i ligjit nr. 49/2012.

**KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË**

pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit, z. Sokol Sadushi dhe diskutoi në dhomë këshillimit çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I. Rrethanat e çështjes.**

1. Kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga pala kërkuuese është paraqitur në Gjykatën e Lartë me datë 23.06.2021. Nëpërmjet shkresës nr. 4333 prot., datë 02.12.2021 të Kancelarit të Gjykatës së Lartë është kërkuar informacion në Gjykatën

Administrative të Apelit lidhur me ecurinë e gjykimit dhe qëndrimin e gjyqtarit relator lidhur me të. Me anë të shkresës nr. 4337/1 prot., datë 13.12.2021 gjyqtari relator ka parashtruar qëndrimin dhe bashkëlidhur dhe në vijim më datë 12.01.2022 janë përcjell aktet e fashikullit të gjykimit. Gjyqtari relator sqaron se çështja nuk është shqyrtuar ende, duke qenë se aktualisht po shqyrtohen akoma çështjet e regjistruara në periudhën shtator 2016 dhe arsyet e vonesës në shqyrtimin e kësaj çështje janë të njejta me ato për mbi 3.700 çështje të tjera dhe lidhen me pamundësinë objektive të përballimit të kësaj ngarkesë brenda një afati të arsyeshëm.

2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se kërkuesit kanë paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në datë 08.02.2019, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të titullit ekzekutiv vendimit për dënimin administrativ nr. 8, datë 09.02.2017 si një detyrim që nuk ekziston, të procesverbalit të inspektimit nr. serie 0010778, procesverbalit të konstatimit të kundravajtjes administrative nr. serie 0002513, të vendimit nr. 1916, datë 19.04.2017 si dhe detyrimin e palës së paditur, Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit Tiranë ti kthejnë paditëses shumën prej 474.000 lekë dhe interesat.

3. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 1183 (80-2019-1225), datë 09.04.2019 ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsë.

4. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim pala paditëse Restore Reduce Recycle Albania. Çështja ende nuk është gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

5. Kërkueset ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm me datë 23.06.2021. Në kërkesë është pretenduar se:

- *Kanë kaluar më shumë se dy vjet nga data e regjistrimit të kësaj çështje. Sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile do duhej të ishte gjykuar çështja brenda datës 27.09.2020 (përfshirë edhe kohën e pezullimit për shkak të pandemisë).*

- *Kërkuesja ka të pezullur veprimtarinë ekonomike prej datës 09.02.2017 kohë në të cilën është vendosur dënimi administrativ objekt gjykimi. Kanë kaluar më shumë se katër vjet, dëmi ekonomik është i konsiderueshëm.*

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ**

6. Kërkesa është paraqitur pranë Gjykatës së Lartë në datë 23.06.2021. Kërkesa është paraqitur nga një subjekt i cili legjitimohet në paraqitjen e kësaj kërkesë. Kërkuesi rezulton të jetë me cilësinë e paditësit në procesin gjyqësor për të cilin është regjistruar ankimi me nr. Regj. Themeltar31157-02091-86-2019, datë 27.05.2019.

7. Kërkesa është në kompetencën e këtij kolegji, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Civile, pasi përmes saj kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

8. Kërkesa i plotëson elementët e parashikuar në nenin 399/5, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu kërkesa është e shoqëruar edhe me të gjitha aktet e tjera të nevojshme, të përcaktuar në nenin 399/5, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile.

9. Rezulton se çështja ka kaluar afatin e shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja a), të Kodit të Procedurës Civile (1 vit). Që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit (më datë 27.05.2019) dhe deri në paraqitjen e kësaj kërkesë (më datë 23.06.2021) ka kaluar një kohë prej (2) vitesh, e 27 (njëzet e shtatë) ditë. Nisur nga afatet e mësipërme rezulton se është tejkaluar afati i parashikuar në nenin 399/2 shkronja a) të Kodit të Procedurës Civile.

10. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin civil/administrativ, pasi përbën dhe një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ky

parim bazohet në postulatën “drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar”. Shkalla e respektimit të këtij parimi përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. (*Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ*). Periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë deri tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. (*shih vendimin Vendimin Qufaj kundër Shqipërisë; Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë 23.11.1993 të GJEDNJ*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

11. Në vlerësim të Kolegjit, parashikimet e neneve 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile kanë për qëllim krijimin e një mjeti procedural që t’u japë zgjidhje rasteve kur konstatohet neglizhencë apo tejzgjatje të procedurave, për të cilat nuk ka një justifikim të arsyeshëm me qëllim respektimin e parimit të një procesi të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNJ. Qëllimi i këtij mjeti është që t’u japë mundësi subjekteve, që ndodhen në kushtet e mësipërme, që të kenë një mjet procedural efektiv që të zgjidhin situatën në të cilën ata ndodhen dhe përmbylljen e procedurave në një kohë sa më të arsyeshme. Në këtë kuptim, ligji ka parashikuar afatet, të cilat konsiderohen të arsyeshme, sipas shkallëve të gjykimit. Neni 399/2 i KPC përcakton se afatet e arsyeshme të gjykimit duhen vlerësuar në raport me rrethanat konkrete që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, konkretisht “Në kohëzgjatjen e gjykimit ose të procedimit, nuk llogaritet koha kur çështja është pezulluar për shkaqe ligjore, kur është shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuese, sipas këtij kreu, ose kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.”. Në nenin 399/9 të KPC identifikohen disa kriteret në lidhje me vlerësimin e standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, konkretisht, “[...] gjykata vlerëson kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e palëve dhe të trupit gjykues gjatë gjykimit, [...] si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen”.

12. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Në referim të kësaj jurisprudence rezulton se në përllogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të 4 ndryshëm, të tilla si: kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative. (*Shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjeliç kundër Sllovenisë ap. nr.50719\06, datë 18.10.2012. të GJEDNJ*).

13. Për sa i përket kompleksitetit të çështjes, ky kriter vlerësimi merr parasysh të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe i dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhja e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedure. (*Shih vendimin Trggiani kundër Italisë datë 19.02.1991; Manieri kundër Italisë dt. 27.02.1992, Stefancic kundër Sllovenisë, datë 25.10.2012 të GJEDNJ*).

14. Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, ky kriter lidhet me mënyrën se si janë sjellë palët në proces ndaj procedimit. Diligjencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij. (*shih vendimin Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane, datë 15.07.1982 të GJEDNJ*).

15. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve për vlerësimin e kohëzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen ose nga autoritetet gjyqësore ose nga autoritetet administrative. Shkaqe të kësaj natyre në jurisprudencën e GJEDNJ janë vënë në



dukje p.sh.: bashkimi i gabuar i disa çështjeve që ka shkaktuar vonesa të panevojshme, shtyrjet e pabazuara në ligj të seancave gjyqësore, pezullimi i kundërligjshëm i procesit gjyqësor, vonesat nga ana e agjencive publike ligjzbatuese të shtetit në dorëzimin e provave të kërkuara nga gjykata, transferimi i çështjeve penale nga një gjykatë në tjetrën, mbajtja e seancave të apelimeve. (*Shih vendimin Eëing kundër Mbretërisë së Bashkuar*).

16. Në çështjen objekt gjykimi konstatohet se në momentin e regjistrimit të kërkesës në Gjykatën e Lartë rezulton se çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit në Gjykatën Administrative të Apelit, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (1 vit). Kolegji duke marrë në vlerësim kriteret e përcaktuar nga jurisprudenca e GJEDNJ në lidhje me standardin e afatit të arsyeshëm nuk konstaton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar, të jetë shtyrë gjykimi për shkak të kërkesave të palës kërkuese. Nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë, që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në këto momente nuk është kryer ndonjë veprim procedural. Çështja nuk paraqitet veçanërisht komplekse për nga natyra e saj.

17. Në lidhje me mosveprimin e gjykatës që nga momenti i depozitimit të ankimit e deri në datën që kërkuesi ka paraqitur kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të shqyrtimit, Kolegji vlerëson se duhet mbajtur në konsideratë neni 399/2 paragrafi 3 i KPC. Nisur nga qëllimi i këtij mjeti procedural (shmangia e neglizhencës apo e tejzgjatjes së procedurave, për të cilat nuk ka një justifikim të arsyeshëm), në vlerësim të Kolegjit, rrethanë që shkakton pamundësi objektive për procedim sipas nenit 399/2 paragrafi 3, përbën edhe një volum i madh i çështjeve, të mbetura pa gjykuar për një kohë të gjatë në raport me një pamjaftueshmëri burimesh njerëzore për të përballuar këtë volum, sepse një situatë e tillë e vë organin gjyqësor në kushtet pamundësisë objektive për procedim. Një situatë e tillë del përtej rastit individual dhe ka të bëjë me një problematikë që përfshin sistemin në tërësi. Kolegji vlerëson se nuk mund t'i kërkohej autoriteteve gjyqësore, që të kryejnë veprime procedurale në tejkalim të limiteve të arsyeshme të mundësive të tyre objektive. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator si dhe ngarkesa e këtij të fundit në raport me gjyqtarët e tjerë. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, gjyqtarja ka depozituar mendim me shkrim ku është parashtruar se rezulton relatore në mbi 3700 dosje, se planifikohen mesatarisht 30 çështje në muaj sipas rendit kronologjik të datës së regjistrimit dhe se arsyet e vonesës në gjykimin e kësaj çështje janë të lidhura me pamundësinë objektive të përballimit të kësaj ngarkese brenda një afati të arsyeshëm.

18. Kolegji vlerëson se mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Gjyqtarja relatore ka përcaktuar kriteret se si merr në shqyrtim çështjet për të cilat ajo është në cilësinë e relatores. Rezultoni se shqyrtimi i tyre bëhet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar. Kolegji, duke marrë në konsideratë rastet që GJEDNJ ka përcaktuar se çfarë përbën sjellje të gjykatës, e cila ndikon në cenimin e parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, vlerëson se rastet kur gjykata është në pamundësi objektive dhe pa vullnetin e saj, për të gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe, akumulimit ndër vite të dosjeve në gjykatë (jo për shkak të gjyqtarit), nuk do të kemi cenim të këtij standardi. Kolegji vlerëson se në rastet kur gjykata është në kushtet e pamundësisë objektive për shkak të ngarkesës së madhe, nuk mund t'i kërkojë gjykatës që të marrë masa për përshpejtim të procedurave, kur konstaton se gjykata ndjek kriteret transparente dhe objektive në përcaktimin e radhës së gjykimit të çështjeve. Një interpretim i kundërt, i cili nuk do të merrte në konsideratë volumin shumë të madh të çështjeve dhe do të detyronte gjykatën të përshpejtonte procedurat pa u mbështetur në kriteret objektive, do të shkaktonte pabarazi në radhën e trajtimit të çështjeve të cilat janë në rrethana të njëjta. Në rastin konkret, Kolegjit i rezulton se gjyqtarja relatore ka marrë të gjitha masat e nevojshme organizative duke

përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve sipas radhës së vjetërsisë të çështjeve që i janë ngarkuar në cilësinë e gjyqtarit relator.

19. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi, e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Duke qënë elementë të një procesi të rregullt, në çdo rast duhet të vendoset një ekuilibër i drejtë mes cilësisë së procesit dhe të vendimmarrjes së gjykatës me afatin e arsyeshëm apo edhe ekonominë gjyqësore në tërësi duke mos dëmtuar cilësinë.

20. Për sa më sipër, Kolegji çmon se duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës pasi nuk vërehet ndonjë zvarritje e qëllimshme e procesit nga gjyqtari relator.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë bazuar në nenin 1/2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe nenit 399/8 të Kodit të Procedurës Civile,

### **VENDOSI:**

- Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Restore Reduce Recycle Albania sh.p.k.

**Tiranë, më 18.07.2022**